



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **13.04.2022** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**. **Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete, përshëndes anëtarët e Komitetit për Komunitete, për përfaqësuesit e OSBE-së, të UNMIK-ut, përshëndetje për shefin e zyrës për komunitete z. Lendrit Qeli dhe gjithë te pranishmit në sallë. Ky është takimi i dytë për vitin 2022, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022
3. Të ndryshme.

Kryesuesi –Të nderuar para se me qitë rendin e ditës në votim a keni diçka për të shtuar, nëse jo atëherë e qesim në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka rreth Procesverbalit të kaluar, atëherë nëse jo e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet Procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2022.

Kryesuesi – Sigurisht se ju e keni pranuar planin e punës për vitin 2021, kështu që kërkoj nga ju nëse ka dikush diçka lidhur me planin për vitin 2022 mund të jepni ndonjë propozim apo pikë shtesë e cila është e nevojshme për tu shtuar.

Skender Hamza – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Desha të ju shpjegoj sa i përket planit të punës për vitin 2022. Realisht nuk ka pasur plan për këtë vit dhe ne tash për mos me vazhdua që me punu pa plan të punës atëherë kemi propozu se bashku me kryesuesin që si shabllon me ju dërgu planin e punës të vitit 2021. Kështu që nëse ka dikush prej anëtarëve të Komitetit për Komunitete që me propozu ndonjë pikë që me ndryshue këtë planë atëherë ne e ndryshojmë planin dhe e aprovojmë dhe nëse jo atëherë nuk do të thotë që ky plan ashtu siç është, brenda muajve kur kemi me pasur mbledhje nuk do të ketë ndërhyrje apo pika shtesë pasi gjithmonë do të ketë, pasi secili anëtar mundet me propozua ndonjë pikë shtesë dhe kryesuesi mundet me dal edhe jashtë këtij plani. Mirëpo tani që mos me punu pa plan kryesuesi ka kërkuar nga ne që të ju dërgojmë planin e vitit 2021.

Shqipe Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Sa i përket planit e shikova me vëmendje por derisa ekziston mundësia me ndërhyje që me marr masa gjate muajve ne vijim, sigurisht edhe unë e përkrahi këtë plan mirëpo me kusht që me pas ndërhyrje të vazhdueshme .

Skender Hamza – Pika të rendit të ditës mundet këtë gjithmonë sipas situatës mund të pika të ndryshme e jo sipas planit si pika strikte.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, e qesim në votim planin e punës për vitin 2022. Konstatohet se miratohet plani i punës për vitin 2022.

Skender Hamza – Kisha kërkuar si sekretari e Kuvendit që janë të pranishëm përfaqësues të UNMIK-ut dhe të OSBE-së që nëse kanë ndonjë propozim sa i përket planit të punës, që realisht në mundemi me prit edhe brenda javës që me pas mundësi me ndërhyje në plan dhe pastaj në mbledhjen e ardhshme ju dorëzojmë planin me pikat që e kemi ndryshuar.

Kryesuesi - Kalojmë ne pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Të ndryshme.

A ka dikush prej anëtareve të Komitetit për Komunitete që dëshiron me marr fjalën.

Edona Kryeziu – Përshëndetje kryesues Morina, te nderuar anëtar të Komitetit për Komunitete, përfaqësues të UNMIK-ut dhe OSBE-së si dhe gjithë të tjerët që janë të pranishëm në këtë mbledhje. Meqë kemi prezent zyrën komunale për komunitete dhe kthim, atëherë do të ju isha drejtuar shëfrit me një pyetje rreth mundësisë së mbështetjes re familjeve me gjendje sociale ekonomike e posaçërisht të atyre që kanë probleme me strehim. Unë po ju referohem një rasti në fshatin Xërxe nga i cili fshat vij edhe unë, për një familje që jeton në kushte tejet të renda dhe ne sa kam dijeni unë merr një shtesë sociale si burim të vetëm të saja familje. E të flitet për gjendjen fizike të shtëpisë mundemi me thanë lirisht se është në një gjendje të mjerueshme dhe fare nuk i plotëson kushtet për jetesë. Kështu që do të ju kisha lutur që nga fondet e zyrës tuaj duke e ditur edhe mundësinë e bashkëpunimit që keni me nivelin qendror të shihet mundësia për intervenim sa më të shpejt të kësaj familje pasi vërtet ka shumë nevojë. Emrin e kryefamiljarit nuk e bëj publike sepse nuk po e di ende nëse do të marr përgjigje pozitive por padyshim nëse po atëherë ju ftoj edhe për një vizitë të kjo familje. Më konkretisht pyetjet e mia lidhur me juve zyrën komunale për komunitet dhe kthim janë që a ekziston ndonjë fond për mbështetje të këtyre familjeve dhe nëse po atëherë sa është e mjaftueshme ky fond për ti plotësuar kërkesat duke e ditur që në komunën tonë ka shumë nevojë e sidomos për familjet që janë me probleme shumë të mëdha për strehim.

Lendrid Qeli – Faleminderit kryesues, te nderuar anëtar të Komitetit për Komunitete. Zyra komunale për komunitete dhe kthim në bashkëpunim me zyrën e kryetarit pasi zyra për komunitete është pjesë e kabinetit të kryetarit, ditët e kaluara e kemi nënshkruar një marrëveshje me një organizatë ndërkombëtare në Kosovë e cila do të merr parasysh mbështetjet në renovimin e shtëpive të disa pjesëtarëve të komuniteteve rom ashkali dhe egjiptian. Për momentin ende nuk e kemi një pasqyrë të saktë se sa do të jetë numri për shkak se buxheti do të jetë i limituar sepse zyra komunale për komunitete dhe kthim ka participue me 10,000 euro, zyra e kryetarit me 5,000 euro dhe donatori me 10,000 euro, kështu që diku rreth 25,000 euro janë për momentin dhe unë jam duke punuar në atë drejtim që edhe me u rrit shuma prej ministrisë për komunitete dhe kthim sepse kjo mbështetje parasheh në fillim dhënien e materialit për një shpi momentale që mundet me u rinovua apo edhe me pa mundësinë që prej fillimit me u ndërtua por që në fakt për momentin i kemi prioritet dy familje dhe nuk e di se a po flasim për familjen e njëjtë në Xërxe dhe një familje që jeton në pjesën e epërme të qytetit që është lagje multietnike ku pak para vitit të ri ka pësuar një djegie të shtëpisë dhe ne konsiderojmë se këto dy raste janë me prioritet por ende ka mbetur me u kordinue me ministrinë për komunitete dhe kthim se sa kanë mundësi me pagu një kompani që do të merret me ndërtimin për shkak se familjet fatkeqësisht nuk kanë mundësi me mbështet procesin e ndërtimit. Pra në këtë pjesë ne kemi pasur edhe një vizitë të zëvendësministrit për komunitete dhe kthim në Rahovec dhe kemi shpresa se do të na mbështet në këtë pjesë. Po ashtu ne do të provojmë edhe nga fondet e qeverisë gjegjësisht të zyrës për çështje të komuniteteve dhe po besoj që ditët në vazhdim do të dalim me një pasqyrë reale pas vizitës që do të kemi në terrene që sa familje do të përfitojnë dhe padyshim që do të krijojmë një komision që mos me gabu askush pasi është vërtet senzitive në kuptimin se pse duhet dikush me u vlerësua me shumë e dikush me pak duke e konsiderua profesionalitetin e komisionit me persona adekuat besoj që do të kemi mundësi që këtë vit të të paktën me zbutë situatën të pjesa e banimit dhe po shpresojmë që çdo vit do të kemi një mbështetje të njëjtë prej organizatës dhe gjithashtu vlen me theksu që pas një lobimi pothuajse dy vjeçar ky donator vjen për herë të parë vjen në komunën e Rahovecit dhe jam i bindur që do të vazhdojmë edhe me tutje.

Përfaqësuesi i UNMIK-ut – Përshëndetje për të gjithë. Mund të bëjmë vetëm një plotësim, me kërkesën e zonjushës, në momentin që anëtari I komitetit e paraqet si çështje atëherë do të ishte mire me dal si rekomandim, se a doni me organizu vizitë në terrene si komitet apo doni me ja lënë këtë zyrës për komunitete që këta me shku me bo vlerësimin. Pasi që ajo ka dal me propozim konkret edhe pse nuk e boni publik emrin por do të ishte mire që komiteti me caktua një ditë që me bo vizitë në terrene edhe atëherë dilni me rekomandim për zyrën për komunitete apo ja lëni në diskrecionin e zyrës.

Shqipe Kryeziu – Unë nuk po e shoh shumë të arsyeshme me dal në teren për derisa kryetari e ka bo marrëveshjen dhe kjo qenë edhe publike kjo marrëveshje por në ndërkohë nëse është e nevojshme mund

edhe te dalim. Kështu që edhe për atë arsye edhe pyeta që mundet me ndërhyje apo mundet me marr masa te pikat e rendit te ditës apo te planifikimi, kështu unë mendoj.

Skender Hamza – Unë kisha kërkuar anëtarja e komitetit për komunitete Edona Kryeziu që me ja dhanë emrin shëfit te zyrës për komunitete z. Lendrit Qeli që me dit se a mendoni për te njëjtën familje dhe me pastaj është ne kompetencën e juaj se a doni me formua komision si komitet apo doni me lanë ne diskrecionin e zyrës për komunitete.

Edona Kryeziu – Unë po mendoj se nuk duhet me bo emrin publik për shkak te ndjeshmërisë se rastit dhe meqenëse jemi te pranishëm këtu shume dhe padyshim se zyrës për komunitet do te ja jap emrin sepse edhe për këtë arsye e kam bo këtë kërkesë mirëpo desha te lidhem me përfaqësuesin e UNMIK-ut nëse nuk është obligative atëherë unë vullnetarisht si anëtare e komisionit do te i bashkëngjitëm zyrës për komunitet dhe me dal me ape edhe nga afër rastin ne fjalë.

Lendrit Qeli – Si informatë shtesë, vizita fillimisht bëhet e donatorin për shkak se ne brendësi te mbështetjes nuk do te jetë vetëm shuma që është totali prej 25,000, por mbështetja do te jetë edhe ne aspektin profesional me inxhinierët e organizatës që e financojnë këtë pjesën e bashkëfinancimit dhe ata kanë me vlersu ne kuptimin e tyre profesional sepse projektet ne njëfarë mënyre janë shabllon ne kuptimin që i kanë realizu neper komunat e tjera, ku vlerta me e madhe e mbështetjes te një shtëpie prej fillimit do te jetë rreth 60m2 pra do te jet diçka modeste për shkak te buxhetit edhe duke marr parasysh që po përballemi me çmime te larta te materialit dhe sigurisht se këtu do t kemi paksa telashe. Ndërsa sa i përket mbështetjes që me dal edhe njëherë ne terrene ose me i rivlerësu bashke, zyra gjithmonë ka qenë e hapur jo vetëm për ju por edhe për shoqërinë civile dhe organizata tjera sepse jemi mundu me qenë gjithmonë transparent dhe e mira kësaj pune është se zyra për komunitete nuk është zyre politike që me jap kaheje tjera ne kuptimin që me favorizua dikënd, kështu që ne jemi te hapur kurdo për rekomandime për mbështetje e sigurisht edhe për vizitë kur i bëjmë ne komunitet.

Kryesuesi – Atëherë unë kisha kërkuar nga anëtarët e komitetit për komunitete që te japin një propozim nëse janë te pajtimit ne bashkëpunim me zyrën për komunitete z. Lendrit Qeli te formohet një komision nga anëtarët e komitetit që te dalin se bashku ne vizitë që me pae për se afërmi rastin ne fjalë dhe sigurisht që unë se bashku me ju te bashkëpunojmë me zyrën për komunitete.

Skender Hamza – A mendoni me dal ne terrene vetëm për këtë kërkesë apo për disa familje që janë me nevojë ne komunën e Rahovecit.

Shqipe Kryeziu – Unë mendoj se duhet ta lejmë për mbledhjen e ardhshme, pasi nëse kërkohet dhe nëse e shohim te arsyeshme te formojmë komision atëherë sigurisht që do ta bëjmë një gjë te tillë.

Përfaqësuesi i UNMIK-ut - Komiteti i rekomandon zyrës që me dal ne terrene dhe me pastaj zyra ne takimin e radhës duhet me raportu për shkak se ju jeni komitet obligativ dhe duhet me shenu ne procesverbal komiteti i rekomandon zyrës për komunitete dhe me pastaj zyrtari duhet me raportu ne takimin e ardhshëm. Kështu që nëse komiteti nuk donë me dal atëherë i rekomandon zyrës për komunitete dhe këta vinë me raport ne takimin e radhës pasi kjo nuk zgjidhet brenda ditës por proceduralisht është ne rregull pasi që duhet me u shënu ne procesverbal, pasi krejt ne fund komiteti i raporton kuvendit dhe ky është veç hapi i parë ne trajtimin e rasteve te tilla, dhe nëse dikush dëshiron që prej anëtareve te komitetit dhe me ju bashku zyrës edhe kjo është ne rregull pasi që zonjusha e ka ngritë si çështje dhe duhet te debatohet dhe te trajtohet.

Shqipe Kryeziu – Përfaqësuesi i UNMIK-ut ishte shume i qartë ehe ne jemi që shefi i zyrës për komunitete me dal ne terrene edhe kur i përgjigjet donatorit edhe Lendritit.

Kryesuesi – Atëherë e qesim ne votim rekomandimin. Konstatoj se unanimisht miratohet rekomandimi.

Ramë Berisha – Përshëndetje për te gjithë, unë e përkrahi këtë iniciativë që te dalim ne terrene pasi është e nevojshme , jo vetëm nga zyra për komunitete por edhe ndonjë prej anëtareve te komitetit e posaçërisht ata që e njohin gjendjen ekonomike te familjeve.

Kryesuesi – Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, konsideroj te mbyllur këtë takim dhe shihemi ne mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi

Agim Hoti



Kryesuesi i Mbledhjes

Bajram Morina